

**Z. Bexhet Zeqiri** ka kryer studimet e larta në Fakultetin Ekonomik, Dega Kontabël.

Theksojmë se Z. Zeqiri ka një eksperiencë të gjatë në sektorin publik.

Karriera e tij e punës ka nisur që në vitin 1982 ku mori pozicionin si Ekonomist, Kryetar Dege, Financë, në Kolonjë, periudhë kohore që zgjati deri më 1989.

Më pas ai merr pozicionin si Kryetar Dege, Financë NB “*Adriatik*”, Krujë për periudhën 1989-1992.

Në vitet 1992-1993 kalon në pozicionin Shef i Seksionit Kontroll i Revizionit, Laç.

Më tej 1993-1995, Drejtor Ekonomik, gazeta “*Republika*”. Gjatë viteve 1995-2005 Z. Zeqiri kaloi në pozicionin Drejtor Ekonomik në Kompaninë Mediatike “*Albania*”, gjithashtu në këto vite mbajti pozicionin si Drejtor Ekonomik pranë “*Lidhja e Gazetarëve të Shqipërisë*”. Të njëjtin pozicion mbajti dhe te Fondacioni “*KONICA*” si Drejtor Ekonomik.

Në vitet 2004-2005 do të angazhohej në sektorin privat, pozicioni Ekonomist pranë Shoqërisë Ndërtimore “*ERA KONSTRUKSION*”.

Marrëdhëniet e punës në Kontrollin e Lartë të Shtetit i nisi prej Shkurtit të vitit 2005.

Fillimisht mori pozicionin e Audituesit të Lartë, në Departamentin e Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme. Ka kryer funksione si Auditues i Lartë, Kryeauditues në Departamente të ndryshme si Departamenti Juridik, i Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit.

Aktualisht z. Zeqiri, është i emëruar në pozicionin e Drejtorit të Departamentit të Shqyrtimit, Mbikëqyrjes dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit dhe Zbatimit të Standardeve.

Gjatë kësaj eksperience të gjatë profesionale, Z. Zeqiri ka kryer një sërë trajnimesh brenda dhe jashtë vendit në lidhje me çështjet e auditimit të jashtëm në sektorin publik.

Z. Zeqiri ka njohuri mjaftueshëm mirë në gjuhën angleze dhe italiane.